

## **Deklaratë mbështetjeje për Dr Arben Taravarin nga anëtarët e ish-Akademisë së Aleancës për Shqiptarët**

Maqedonia e Veriut po shkon drejt zgjedhjeve parlamentare më 8 maj 2024. Këto zgjedhje vijnë në një krizë të rëndë shoqërore, morale dhe ekonomike, si dhe në një situatë të minuar nga korrupsioni i shfrenuar i zyrtarëve qeveritarë dhe i oligarkëve rreth tyre.

Ky konstatim tanimë është objekt konsensusi edhe në mesin e aleatëve tonë kryesorë. Me fjalët e Ambasadorës së SHBA-ve, Angela Aggeler, jemi përballë një epidemie korrupsioni, e cila vetëm se është përkeqësuar gjatë dy viteve të fundit për shkak të rritjes së pandëshkueshmërisë sipas ambasadorit evropian David Geer, gjë që ka vënë në rrezik edhe anëtarësimin e vendit në BE siç e ka potencuar ambasadori holandez Dirk Jan Kop. Këmbanat bien për ata që kanë veshë.

Në kampin politik shqiptar, përgjegjësi kryesor dhe katalizatori i kësaj krize ka emër: Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) që ka udhëhequr thujse pandërprerë mbi dy dekada me radhë. Partizimi i drejtësisë dhe ndikimi politik në gjyqësor nga ana e BDI-së ka sjellur një gjendje ku vetëm 2% e qytetarëve i besojnë sistemit të drejtësisë. Akaparimi i resurseve të shtetit nga BDI-ja dhe nga oligarkët e saj të simbolizuar nga Soravia, Eurovia dhe Llotaria, ka varfëruar shqiptarët dhe mbytur shpresën e tyre, duke shkaktuar ikjen më masive të rinisë dhe fuqisë punëtore në historinë e vendit. Kapja e mediave dhe e shoqërisë civile nga Ministria për Sistem Politik ka ngulfatur fjalën e lirë dhe po rrezikon themelet e demokracisë në shoqërinë shqiptare në vend.

Kjo gjendje nuk duhet dhe nuk guxon të vazhdojë. Tani që Maqedonia e Veriut po shkon drejt zgjedhjeve të reja, kemi një mundësi e papërsëritshme për një ndryshim të madh politik, një ndryshim të sigurt. Konsolidimi i opozitës shqiptare, e përkrahur nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, është sihariq i fitorës së shqiptarëve.

Qeverisja me duar të pastra, lufta e pakompromistë kundër korrupsionit, zhvillimi dhe mbi të gjitha, kthim i shpresës është ajo që kërkojnë shqiptarët. Këto çështje nuk janë veçori specifike të shoqërisë së Maqedonisë së Veriut e as të shqiptarëve, por janë vlera universale për të cilat mëton çdo njeri. Tani është në dorën e Dr Arben Taravarit dhe Aleancës për Shqiptarët që të dëshmojnë se ndryshimi është i mundur.

Ne, si anëtarë të përbërjes së fundit të Akademisë të Aleancës për Shqiptarët, organ strategjik-këshillëdhënës përgjegjës për ndërtimin e politikave strategjike të partisë në të gjitha nivelet, kemi besim të plotë dhe e përkrahim pa rezervë liderin e Aleancës për Shqiptarët, Dr Arben Taravarin, në rrugën që ai ka trasuar për sjelljen e ndryshimit të sigurt në kampin politik shqiptar.

Besojmë se qeveria e ardhshme e Aleancës për Shqiptarët me në krye Dr Arben Taravarin do të ofrojë një fillim të ri në këtë betejë të vështirë, por të domosdoshme, përkundër sfondit të ngjarjeve në rajon dhe në botë. Në këtë rrugë, nuk kemi asnjë dyshim se partitë politike shqiptare do të jenë unike në atë se nuk ka vota shqiptare për cilindo mandatar për Kryeministër i cili nuk i garanton ndryshimet kushtetuese dhe hapjen e negociatave për anëtarësimin e vendit në BE.

Dr Arben Taravari është shpresë. Shpresë se ende ekzistojnë liderë politik që udhëhiqen nga parimet etike dhe që kanë bindje dhe besim politik pas të cilit qëndrojnë të pakompromis. Jemi të bindur se Dr Arben Taravari do të ecë rrugës së drejtë, rrugës së shtruar nga Arbën Xhaferi, dhe do t'i prijë transformit të realitetit të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

### **Nënshkruesit :**

Halil Snopçe  
Agron Rustemi  
Arben Fetai  
Arif Selami  
Azir Aliu  
Bekim Bina  
Besim Memedi

Besim Verdi Abdullahi  
Bujar Raufi  
Ejup Murtezani  
Ekrem Ismaili  
Gafur Xhabiri  
Ismail Ferati

Jaumin Ajdari  
Lulzim Farizi  
Namik Durmishi  
Shazim Memedi  
Skender Palloshi  
Zeqir Kadriu